



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:274131
Datë: 27.03.2024
Numri i dokumentit: 05509793

A.nr.455/18

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtarin Kreshnik Kaçiu dhe zyrtaren ligjore Shqipe Jashari, në konfliktin administrativ të paditësit S.. B. nga fshati Gj..., komuna e K..., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Rr..B., avokat nga K..., kundër të paditurit Komisioni Qeveritar për verifikimin e veteranëve dhe kategorive tjera të UÇK-së me seli në Prishtinë, për shkak të kërkesës për njohjen e statusit të Veteranit të luftës së UÇK-së, pas shqyrtimit kryesor publik, me datë 27.03.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET si e pabazuar padia dhe kërkesëpadia e paditësit S.. B. nga fshati Gj..., komuna e K..., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Rr..B., avokat nga K..., me të cilën ka kërkuar njohjen e të drejtës së statusit të veteranit të luftëtarit të UÇK-së.

II. Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Shqyrtimi kryesor në këtë çështje juridike është mbajtur në pajtim me nenin 41 të LKA-së, me praninë e paditësit dhe të autorizuarit të tij, e në mungesë të palës së paditur të ftuar në mënyrë të rregullt.

Paditësi me padinë e datës 16.03.2018 ka pohuar se e paditura nuk i ka njohur statusin e veteranit të luftës së UÇK-së. Poashtu shton se nga Komisioni i ishte njohur statusi i pjesëtarit të luftës së UÇK-së duke theksuar se i njëjti ka qenë ushtar i rregullt i UÇK-së që nga fillimi i luftës dhe se për këtë dëshmojnë edhe bashkëluftëtarët e tij. I propozon Gjykatës aprovimin e padisë dhe kërkesëpadisë dhe njohjen e statusit të veteranit të UÇK-së.

Në seancën e shqyrtimit kryesor, përfaqësuesi i paditësit deklaroi: *“Fillimisht theksojmë se kjo gjykatë në seancën e dt. 21.11.2023, kishte marr Aktgjykim me të cilin kishte aprovuar kërkesëpadinë paditësit. Pasi që obligimin e kësaj gjykate në afat prej 30 ditësh duke mos nxjerr vendim , paditësi ka dërguar parashtresë të paditurës me dt. 28.12.2023, me të cilën kishte kërkuar që e njëjta të merr vendim në afat ligjorë siç kishte vendosur kjo gjykatë. Pasi që e paditura nuk kishte vendosur në afat ligjorë, paditësi ka njoftuar gjykatën me parashtresë dt. 09.01.2024 duke cekur se e paditura nuk ka vendosur siç e ka obliguar gjykata . Duke u bazuar në këtë të dhëna kërkoj nga kjo gjykatë të merr vendim meritorë duke ia njohur të drejtën paditësit për njohjen e statusit të veteranit të UÇK-së, nga data e paraqitjes së padisë. Shpenzimet e procedurës i kërkojmë dhe atë 156 € për padi, 50 për taksë gjyqësore, për 2 seanca 270€”.*

Ndërkaq në fjalën përfundimtare deklaroi: *“Gjykatës i propozoj aprovimin e padisë dhe kërkesëpadisë si e bazuar , dhe ti njohët statusi i veteranit luftetar i UÇK-së, sipas ligjit mbi veteranët dhe drejtat tjera që i takojnë nga dita e paraqitjes së padisë dt.13.03.2018, në mënyrë retroaktive”.*

E paditura me përgjigjen në padi të datës 29.09.2022 e ka kontestuar në tërësi si të pabazuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses, duke pohuar se vendimi i atakuar është marrë konform të gjitha dispozitave në fuqi dhe ajo në të cilën pretendon pala se ky vendim është marrë me shkelje ligjore nuk qëndron fare. Për arsye se vendimi i atakuar është marrë konform legjislacionit në fuqi dhe në mënyrë të drejtë, ashtu që pretendimet e veta pala paditëse nuk i ka vërtetuar as edhe me një provë, andaj e paditura i propozon Gjykatës që të marr Aktgjykim me të cilin refuzohet në tërësi si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit dhe mbetet në fuqi vendimi i të paditurës

Me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, gjykata bëri administrimin e provave dhe atë: Aplikacioni për njohjen e statusi të veteranit i dt.05.02.2013, shkresa nga Nazmi Berisha pa datë, deklarata nga Valdet Berisha dt.11.07.2016, ankesa e dytë e dt.31.03.2016, kërkesa e përsëritur e dt.21.02.2018, shkresa pa titull e dt.27.07.1998, deklarata e paditësit dhe deklarata e Remzi Vishaj e dt.18.12.2017, deklarata e nënshkruar nga Miftar Hasani Nazmi Berisha dhe Valdet Berisha e dt.27.02.2018, lista e rojës me dt.30.01.1999 e tutje , 29.01.1999, 18.06.1999 dhe 15.06.1999.

Pas administrimit të provave të lartëcekura, mbi bazën e nenit 43 të Ligjit për Konfliktet Administrative, gjykata gjeti se padia dhe kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar.

Gjykata vlerësoi se e paditura kishte rënë në heshtje administrative në raport me kërkesën e paditësit për t'ju njohur statusi i Veteranit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, prandaj paditësi kishte ushtruar padi me të cilën ka kërkuar nga gjykata që të vendos në mënyrë meritore lidhur me kërkesën e tij.

Në lidhje me këtë çështje juridike, gjykata me Aktgjykimin A.nr.455/18 të datës 22.11.2023 e kishte aprovuar padinë e paditësit duke e detyruar të paditurën që brenda afatit prej 30 ditësh të nxjerr vendim në lidhje me ankesën e paditësit. Me parashtrësën e datës 11.01.2024, përfaqësuesi i paditësit kishte njoftuar gjykatën se e paditura nuk kishte nxjerrë vendim sipas Aktgjykimit duke i propozuar gjykatës që vet të vendos çështjen.

Me datë 15.01.2024, gjykata kishte kërkuar nga e paditura dhënien e njoftimit mbi shkaqet për të cilat nuk është nxjerrë akti administrativ, ndërkaq e paditura ndonëse e kishte pranuar këtë Kërkesë të Gjykatës me datë 18.01.2024, nuk kishte kthyer asnjë përgjigje dhe nuk kishte dhënë asnjë njoftim.

Mbi këtë bazë, gjykata vendosi meritorisht në lidhje me padinë e paditësit sa i përket kërkesës për njohjen e statusit të veteranit të UÇK-së dhe erdhi në konstatim të qartë se padia e paditësit është e pabazuar. Këtë vlerësim gjykata e bëri duke u bazuar fillimisht në nenin 3 paragrafin 1, nën-paragrafin 1.3.2 të Ligjit Nr. 04/L -261 Për Veteranët e Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, ku përcaktohet: *“1.3.2. Veteran luftëtarë i UÇK –së – është qytetari i Kosovës dhe shtetasi i huaj i cili është radhitur në radhët e UÇK- së, dhe është regjistruar si ushtar i armatosur dhe i uniformuar nga komandat, shtabet e zonave operative të UÇK-së, përkatësisht Shtabi i Përgjithshëm i UÇK së, dhe i cili ka qenë aktiv deri në përfundimin e luftës”*

Gjithashtu gjykata i'u referua edhe nenit 16 paragrafit 1 të Ligjit Nr. 04/L -261 Për Veteranët e Luftës Së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, ku përcaktohet se: *“Veterani Luftëtar i UÇK-së, përmes njohjes së të drejtës në pension dhe beneficione të ndryshme i sigurohet mbështetje financiare dhe benefite të caktuara për kontributin e dhënë në luftën e UÇK-së”*.

Nga provat e administruara gjykata konstatoi se paditësi nuk ka ofruar prova të mjaftueshme për të vërtetuar se i njëjti ka qenë veteran luftëtar në luftën e UÇK-së.

Në ndërlidhje me dispozitat e lartëcekura, gjykata nga provat materiale gjeti se paditësi nuk i plotëson kushtet për njohjen e statusit të veteranit, rrjedhimisht nuk i takojnë as të drejtat dhe përfitimet materiale, kjo duke u bazuar në nenin 3 par.1 të Ligjit Nr. 05/L -141 Për Ndryshimin Dhe Plotësimin

E Ligjit Nr. 04/L -261 Për Veteranët E Luftës Së Ushtrisë Çlirimtare Të Kosovës, ku thuhet: *“1. Neni 16 i ligjit bazik paragrafi 4 riformulohet si në vijim: 4. Të drejtën në përfitim financiar e ka vetëm Veterani Luftëtar i UÇK-së, i cili i plotëson kushtet e përcaktuara me këtë ligj”*.

Gjykata poashtu gjeti se paditësit i mungon Vërtetimi i lëshuar nga Zyra për Çështje të Kategorive të Dala nga Lufta, kërkesë kjo nga neni 10 i Udhëzimit Administrativ (MPMS) Nr.01/2015 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr.06/2012 për procedurat e aplikimit në skemën e pensioneve dhe beneficioneve të përcaktuara në Ligjin Nr.04/L-054 për Statusin dhe të Drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave civile dhe familjeve të tyre, Ligji Nr.04/L-172 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.04/L-054 për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave të dhunës seksuale të luftës, viktimave civile dhe familjarëve të tyre dhe Ligjin Nr.04/L-261 për Veteranët e luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, ku me nenin 10 të këtij Udhëzimi, pas nenit 14 të Udhëzimit bazik, shtohet neni 14A, në të cilin në mënyrë decidive, në nenin 14A, paragrafin 1, nën-paragrafin 1.2, si dokumentacion i nevojshëm për realizimin e pensionit të veteranit luftëtar të UÇK-së kërkohet, ndër të tjera edhe Vërtetimi i lëshuar nga Zyra për Çështje të Kategorive të Dala nga Lufta.

Në këtë drejtim, gjykata nuk gjeti asnjë dëshmi të vetme, me të cilën do të argumentohej që paditësi të ketë zhvilluar aktivitete luftarake në luftën e UÇK-së, apo që paditësi të ketë marrë pjesë në ndonjë organizim ushtarak, frontal apo gueril kundër forcave armike.

Gjykata gjithashtu vlerësoi nga provat e administruara se për të marrë beneficinet si dhe statusin e Veteranit të UÇK-së, paditësi është dashur të jetë radhitur nga radhët e UÇK-së, dhe është regjistruar si ushtar i armatosur dhe i uniformuar nga komandat, shtabet e zonave operative të UÇK-së, përkatësisht Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, për tu përmbushur kështu në plotëni neni 3, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.3.2. i Ligjit Nr. 04/L -261 Për Veteranët e Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Gjykata në marrjen e këtij vendimi meritor u bazua në nenin 7.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) ku është përcaktuar: *“palët kanë për detyrë që të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla”*, nenin 319 I LPK-së paragrafi 1 i cili përcakton: *“Secila nga palët ndërgjyqëse ka për detyrë të provojë faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta”*, në nenin 322 paragrafi 1 ku përcaktohet: *“Në qoftë se gjykata në bazë të provave të marra (neni 8 i këtij ligji) nuk mund të konstatojë me siguri ndonjë fakt, për ekzistimin e faktit do të përfundojë duke i aplikuar rregullat mbi barrën e proves”* si

dhe në nenin 2 të LPK-së, i cili përcakton se: *“Pala që pretendon se i takon një e drejtë ka për detyrë të provojë faktin që është qenësor për krijimin ose realizimin e saj, po që se ligji nuk parasheh diç tjetër”*, e ku në rastin konkret paditësi ka dështuar që të argumentoj pretendimet e tij dhe për arsyet e lartcekura gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Gjykata vlerësoi edhe pretendimet tjera të paditësit, por të njëjtat i refuzoi si të pa bazuara, nga arsyeja se paditësi të njëjtat nuk i ka provuar me fakte dhe prova të cilat do të ndikonin që gjykata të mund të vërtetoj një tjetër gjendje faktike nga kjo e vërtetuar me këtë Aktgjykim. Mbi këto arsye, gjykata kërkesëpadinë e paditësit nuk e aprovoi, sepse vlerësoi se nuk është zbatuar ligji në dëm të njëjtit.

Vendimin lidhur me shpenzimet e procedurës, u mor në bazë të nenit 64 të LKA-së.

Duke u bazuar në arsyet e dhëna me lartë, e në kuptim të nenit 43, paragrafit 3, 46, paragrafi 2, lidhur me nenet 5, 6, 38 dhe 67 të Ligjit për Konfliktet Administrative, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

Departamenti për Çështje Administrative

A.nr.455/18, datë: 27.03.2024

Gj y q t a r i

Kreshnik Kaçiu

Këshillë Juridike: Kundër këtij aktgjykimi është e Lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të Njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.